




REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E GJILANIT
 OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu
 Zaštitu / Department of Health and Social Welfare**

Datë: 02/03/2023

Nr: 04-453/01-22638/23

Në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave **Nr: 04/2017**, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nxjerr këtë :

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE

Për mbështetje financiare publike për projekte /programe/, të Organizatave Jo-Qeveritare në fushën e mirëqenies sociale.

-I-

1. Për implementimin e thirrjes publike, do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ^{ve}.
2. Mbështetja financiare publike për projektet /programet/ e OJQ^{ve}, nga Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale **kodi ekonomik: 10/651/73036/21200/00000/0760** dhe **kodi: 21/73036/21200/00000/0760** në kuadër të programit /nënprogramit/ të subvencioneve.

-II-

1. Mjetet do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ^{ve}. Sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

-III-

1. Dokumentacioni i zbatimit të thirrjes publike sipas nenit II, të këtij Vendimi përfshinë:

1. Tekstin e thirrjes publike
2. Udhëzimin për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1, të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ^{ve}, të financuara nga burimet publike
6. Deklarata për aktivitetet e kontraktuarit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

-IV-

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (**web faqe**)

-V-

Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ^{të} dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijoj një komision vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për pikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ^{ve}.

-VI-

1. Pasi të merret Vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr Vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve /programeve/ të OJQ^{ve}.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

-VII-

Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe protokollimit.

